



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; site .klsh.org.al

Nr. 244/11 Prot.

Tiranë, më 29.06.2018

V E N D I M

Nr. 62, Datë 29.06.2018

PËR

AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRINË TË USHTRUAR NË BASHKINË LUSHNJË për periudhën 01.01.2016 – 31.12.2017

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Lushnjë, për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë për periudhën 01.01.2016 – 31.12.2017 rezultoi se në përgjithësi janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Lushnje, sipas programit të auditimit nr.244/1, prot., datë 05.03.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2016 - 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

a) Në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Lushnjë të vitit 2012, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 22, datë 26.03.2012, nuk pasqyrohen përshkrimet e punës dhe detyrat individuale që duhen kryer, ndarja e detyrave për secilin punonjës si dhe nuk janë vendosur rregulla të qarta, për të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

b) Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Lushnjë, për detyrat e administratës në Njësitë Administrative është pa datë dhe pa vendim miratimi, vetëm e sigluar nga titullari i institucionit. Kjo rregullore nuk është hartuar sipas ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe konkretisht neni 64 “Detyrat dhe të drejtat e Kryetarit të Bashkisë”.

c) Nuk është miratuar një sistem i rregullave specifike dhe të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, bazuar në Manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

d) Nuk janë përcaktuar rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. III dhe nuk ka rregulla të shkruara lidhur me monitorimin e aktiveve të qëndrueshme sidomos për aktivet e dhëna me qira.

e) Nga titullari i njësisë publike nuk është miratuar korrespondencë elektronike dhe nuk është vënë në funksionim sistemi i informacionit dhe komunikimit si dhe mënyra e komunikimit brenda institucionit të cilat realizohen nëpërmjet takimeve për secilën Drejtori, Njësi Administrative, Rajon, Sektor dhe Zyrë.

f) Bashkia e Lushnjës, nuk ka miratuar kodin e etikës profesionale për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 20 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

g) Si rezultat i mungesës së Rregullores së Brendshme në Bashkinë Lushnjë, nuk ka rakordim midis drejtorive dhe sektorëve të ndryshëm në bashki. Kjo ka shkaktuar mungesë të shkëmbimit të informacionit për të ardhurat që pushteti vendor duhet të sigurojë nga drejtori të ndryshme, nga aktivitete të ndryshme dhe nga tarifa apo taksa të ndryshme që aplikohen për veprimtari të caktuara. Rrjedhimisht, drejtoria e të ardhurave në përbërje të së cilës ka edhe një sektor për vjeljen dhe ndjekjen e borxhit, nuk e ka informacionin e domosdoshëm për ndjekjen e procedurave të nevojshme për arkëtimin e këtyre të ardhurave. Nuk janë bërë rregullisht akt-rakordimet periodike me agjentët tatimorë, me QKB-në dhe me institucionet e tjera të cilat menaxhojnë dhe disponojnë informacion për subjektet tatimpaguese. (Më hollësisht trajtuar në pikën A faqet 74 -95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë të ngrihet grupi i punës për hartimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Bashkisë dhe 10 Njësive Administrative e Rajoneve në vartësi të saj duke garantuar dhe përcaktuar qartë për secilin punonjës, ndarjen e detyrës, hierarkinë, dhe duke vendosur rregulla të qarta, për të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

1.2 Rekomandimi: Në zbatim të kërkesave të nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Bashkia Lushnjë të miratojë kodin e etikës profesionale për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë, duke mundësuar krijimin e një mjedisi të brendshëm stimulues (lidhur me statusin e punonjësve të rekrutuar).

1.3 Rekomandimi: Në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. III. të përcaktohen rregulla për

administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme, mbrojtjen dhe monitorimin e tyre, nxjerrjen jashtë përdorimit sidomos për aktivet e dhëna me qira.

1.4. Rekomandimi: Në Rregulloren e Brendëshme të Bashkisë Lushnje, të përcaktohet qartë detyrimi që duhet të kenë drejtoritë e ndryshme të bashkisë për të rakorduar periodikisht me drejtorinë e të ardhurave dhe me të financës për ndjekjen e pagesave, borxheve të krijuara, kamatë-vonesave, etj. Të kërkohet vazhdimisht rakordimi me agjentët tatimorë dhe të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse. Në rast të mosreagimit nga këto institucione, të kërkohet zgjidhja e problemeve në rrugë administrative në instanca më të lartë, në rrugë gjyqësore apo të tjera, sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Lushnjë për vitin 2016 janë lidhur 15 kontrata punimesh dhe shërbimesh në vlerën 444,253,463 lekë me fonde të Bashkisë + grand i pa kushtëzuar dhe nga FZHR për vitin 2017 janë lidhur 24 kontrata punimesh, shërbimi, mallrash në vlerën 709,519,669 lekë, kontrata të cilat përfundojnë gjatë dy –tre viteve dhe konkretisht për vitin 2017 në vlerën 298,327,727 lekë, për vitin 2018 në vlerën 359,752,388 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 51,439,554 lekë të cilat nuk janë kontabilizuar në momentin e lidhjes së tyre si detyrim i konstatuar në llogarinë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” (Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqet 74 -95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Lushnjë, të merren masat për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerat e kontratave të lidhura gjatë vitit ushtrimor me afat një vjeçar ose shumë vjeçar si detyrim i konstatuar në llogaritë furnitorë e llogari të lidhura me to.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: a- Bashkia Lushnjë ka pasqyruar detyrime të prapambetura në pasqyrat financiare por të pa shoqëruara me dokumente justifikuese.

Në llogarinë 401–408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” nga totali prej **203,308,136 lekë** rezultojnë detyrime kreditore ndaj furnitorëve për mallra shërbime dhe punime të kryera, i mbartur nga vitet 2008 deri në vitin 2011, në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabile”, pjesa e parë, “Rregulla të përgjithshme” kapitulli i parë “Mbajtja e kontabilitetit”; UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njëjstive që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njëjstive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”. Detyrimet e prapambetura në vlerën **203,308,136 lekë** janë shndërruar në një burim i vazhdueshëm i rrezikut financiar për subjektin. Bashkia Lushnjë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura është vendosur në vështirësi serioze financiare dhe nëse nuk del nga kjo situatë, atëherë ajo mund të hyjë në situatën e paaftësisë paguese (Më hollësisht trajtuar në pikën A, në faqet 17-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

b- Bashkia Lushnjë ka pasqyruar detyrime të prapambetura në pasqyrat financiare por të pa shoqëruara me dokumente justifikuese. Në llogarinë 401–408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” nga totali prej **203,308,136 lekë** rezultojnë detyrime kreditore 54 subjekte në vlerën **6,359,641 lekë** i cili është detyrim i pa definuar, pa dokumentacionin përkatës për t’u paraqitur si detyrim ndaj furnitorëve për mallra shërbime dhe punime të kryera, i mbartur nga vitet 2008 deri në vitin 2011, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur, në kundërshtim me nenin 3, pika 1, të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”,

VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabile”, pjesa e parë, “Rregulla të përgjithshme”, kapitulli i parë, “Mbajtja e kontabilitetit”, UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” (Më hollësisht trajtuar në pikën A, në faqet 17-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Lushnjë të merren masat për të saktësuar dhe përcaktuar sipas subjekteve debitorë vlerën prej **203,308,136 lekë**, detyrime të prapambetura duke e shoqëruar me dokumentacionin justifikues përkatës dhe duke e pasqyruar në kontabilitet brenda vitit ushtrimor si detyrim ndaj furnitorëve për mallra shërbime dhe punime të kryera.

- Kryetari i Bashkisë Lushnjë me Drejtorinë e Financës, të hartojë një plan për daljen nga situata e vështirë financiare dhe ta dërgojë për miratim në Këshillin Bashkiak propozimin, bazuar në disa nga alternativat e mundshme:

a) Bashkia, me burimet e veta në dispozicion, të marrë masat për të risjellë situatën e pagesave në normalitet brenda një afati të përcaktuar nga Këshilli Bashkiak.

b) Të mundësojë përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës për të reduktuar detyrimet ndaj të tretëve;

c) Të mundësojë rishikimin e buxhetin për të adresuar problemin, duke ndryshuar zërat e shpenzimeve;

ç) Të mundësojë rritjen e nivelit të taksimit, brenda kufijve të lejuar në ligj;

d) Të mundësojë negocimin me kreditorët për të ristrukturuar pagesat për detyrimet e konstatuara dhe të pa likuiduara.

3.2 Rekomandimi:

Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Lushnjë, të merren masat për të saktësuar dhe përcaktuar sipas 54 subjekteve vlerën kreditore prej **6,359,641** lekë ose duke paraqitur në Këshillin e Bashkisë.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në fund të vitit 2017, në llogarinë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”, është pasqyruar detyrimi nga **176** persona dhe subjekte në vlerën **212,941,633** lekë, si detyrim nga 10 Njësitë Administrative, nga të cilat vlera 158,529,899 lekë është detyrim për taksën e tokës bujqësore paraqitur nga Njësitë Administrative, ndërsa 56,411,734 lekë është kryesisht detyrim i pa arkëtuar lënë nga KLSH në auditimet ndër vite.

- Detyrimet e prapambetura nga 10 Njësitë Administrative deri në datë 31.12.2017, të cilat janë paraqitur në pasqyrat financiare të Bashkisë Lushnjë janë në vlerën **158,380,661 lekë**.

- Bashkia Lushnjë ka pasqyruar detyrime të prapambetura në pasqyrat financiare nga viti 2003 deri në vitin 2010, nga **117** persona dhe subjekte në vlerën **19,120,965** lekë, por të pa shoqëruara me dokumente justifikuese në kundërshtim me nenin 3, pika 1, të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabile” pjesa e parë “Rregulla të përgjithshme” kapitulli i parë “Mbajtja e kontabilitetit”, UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” (Më hollësisht trajtuar në pikën A, në faqet 17-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi:

Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Lushnjë të merren masat për të saktësuar dhe përcaktuar sipas 117 subjekteve dhe personave vlerën debitore prej **19,120,965** lekë.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga magazina janë asgjësuar vlera materiale të vlerësuara për jashtë përdorimit në masën **159,378 lekë** gjithsej, nga të cilat për vitin 2016, në vlerën **65,533 lekë** dhe për vitin **2017** në vlerën **93,845 lekë**, por të pa rivlerësuara për ato vlera që mund të përfitohen nga zbërthimi i tyre para asgjësimit, si dhe nuk është bërë sistemimi në kontabilitet, veprime në papajtueshmëri me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 pika 3, neni 16 pika 2, neni 23 pika 5 dhe të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kreu III, pika 35 germa c “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, pika 42-50, kreu IV pika 109, neni 73 deri në nenin 106. (Më hollësisht trajtuar në pikën A, në faqet 17-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Lushnjë të merren masat për seleksionimin e materialeve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit para asgjësimit të tyre me qëllim përfitimin sa më të mundshëm të ndonjë vlere materiale nga zbërthimi i tyre në dobi të institucionit me natyrë druri dhe hekuri si karrige, tavolina, stola, kazma, lopata, sëpata, çekiç, varëse rrobash, tubo, etj.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare vjetore detyrimet për taksat dhe tarifrat vendore të prapambetura nga viti 2011 deri në vitin 2017 nuk janë pasqyruar në kontabilitet si vlerë për tu arkëtuar nga subjektet e biznesit të vogël, subjektet e biznesit të madh, në vlerën **134,433,765 lekë** gjithsej, nga të cilat detyrimi në vlerën 110,106,867 lekë dhe kamat vonesa në vlerën 20,681,661 lekë, detyrimet për taksën e tokës në vlerën **245,105,403 lekë** dhe detyrimet për shlyerjen e taksave e tarifave vendore nga subjektet familjare në vlerën **81,331,585 lekë** në total vlera **460,870,753 lekë**. Detyrimet nga taksat dhe tarifrat vendore evidentohen dhe ndiqen nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore e cila ka strukturë të posaçme për këtë qëllim.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 3, pika 1, të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabile” pjesa e parë, “Rregulla të përgjithshme” kapitulli i parë, “Mbajtja e kontabilitetit”, UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njëjstive që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njëjstive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”, ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, kapitulli III, pika 42-50 (Më hollësisht trajtuar në pikën A, në faqet 17 -74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës të Bashkisë Lushnjë të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera për të ardhurat vendore nga viti 2011 deri në vitin 2017 në vlerën **460,870,753 lekë** sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Struktura dhe rekrutimi i punonjësve të Policisë Bashkiake është hartuar dhe zbatuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, “Për

organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”, i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998, ku në nenin 1, paragrafi 2 të të cilit përcaktohet se: “Policia bashkiake dhe e komunës është organ ekzekutiv...” dhe në nenin 2, në të cilin përcaktohet se: “Policia e bashkisë dhe e komunës, si rregull, ka këtë strukturë: - inspektori (- shefi i seksionit të policisë në bashki ose në komunë); - policë.” (Më hollësisht trajtuar në pikën A, në faqet 17 -74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi:

Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Lushnjë, të merren masa për riorganizimin e strukturës së Policisë Bashkiake në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”, i ndryshuar me ligjin nr. 8335 datë 23.04.1998, në nenin 1, paragrafi 2.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionimit të organizimit të Policisë Bashkiake rezultoi se nuk ka gjetur zbatim kërkesa e pikës 2 të VKM nr. 1497, datë 19.11.2008, “Letra me vlerë” i ndryshuar, në administrimin dhe dokumentimin e gjobave (Më hollësisht trajtuar në pikën A, në faqet 17 -74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës dhe Policia Bashkiake të merren masat për dokumentimin dhe arkëtimin e gjobave sipas kërkesave të pikës 2 të VKM nr. 1497, datë 19.11.2008, “Letra me vlerë” i ndryshuar.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Lushnjë, u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesit të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Në total treguesit e buxhetit gjatë vitit 2016 janë realizuar në masën 65 %, nga i cili zëri “Investime”, i cili zë rreth 60% të totalit të buxhetit vjetor, është realizuar me vlerën më të ulët, ose në masën 57%. Për vitin 2017, treguesit e buxhetit janë realizuar në masën 71%, nga i cili zëri “Investime”, i cili zë rreth 40% të totalit të buxhetit vjetor, është realizuar në masën 64%. Totali i planifikuar i të hyrave për vitin 2016 është 1,518,987 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 82,3% pra 1,250,104 mijë lekë. Për vitin 2017 totali i planifikuar i të hyrave është 1,383,529 mijë lekë dhe të hyrat e realizuara janë 1,135,364 mijë lekë, ose 82.1%. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve (Më hollësisht trajtuar në pikën B, në faqet 74 -95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Bashkia Lushnjë të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Si rezultat i mos marrjes së masave të duhura për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore, deri në datën 31.12.2017, janë krijuar debitorë:

- 245,105,403 lekë për taksën e tokës, nga të cilat janë kontabilizuar 156,529,899 lekë dhe 88,575,504 lekë janë të pakontabilizuara;
- për taksat e tarifave të familjarëve 81,331,585 lekë të pa kontabilizuara, për bizneset (detyrim + kamatë) është 134,433,765 lekë, (21,644,038 + 18,634,735 + 94,154,992) të pa kontabilizuara;
- për kontratat e qirave të tokave/trojeve (detyrim + kamatë) është 1,446,964 lekë të pa kontabilizuara;
- për 864 objekte me sipërfaqen totale 119,730 m² duhej të arkëtoheshin 18,781,075 lekë, si taksë e ndikimit në infrastrukturë, e cila duhet të derdhet nga ALUIZNI, në rolin e agjentit

tatimor, pa kontabilizuar (119,730 m² x 31,375 lekë x 0.5%), shumë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Lushnjë për vitin 2015, 2016, 2017 (*Më hollësisht trajtuar në pikën B, në faqet 74 -95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës dhe me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për saktësimin e vlerave debitorë të përshkruara më sipër dhe për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **481,098,792 lekë**. Për bizneset, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:**

a- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore RSH”.

b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në RSH” të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten në vazhdimësi kamatë vonesat.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, - *Mospagimi i taksave dhe tatimeve*.

e. Zyra e taksave dhe tarifave vendore të evidentojë dhe listojë në mënyrë elektronike **abonentët familjarë** dhe të merren masa për arkëtimin e taksës së tokës **nga fermerë**, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, **të njoftohen** tatimpaguesit familjarë **edhe në median lokale** të Bashkisë për të paguar detyrimin tatimor. Në zbatim të pikës 76, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, njoftim vlerësimet t’ju dërgohen nëpërmjet Zyrës Postare familjarëve të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave, gjelbërimit etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Lushnje është audituar nga KLSH dhe me shkresën nr. 242/4, datë 09.05.2016 janë dërguar rekomandimet për përmirësimin e gjendjes. Për masat e marra ka njoftuar KLSH-në me shkresën nr. 2225, datë 03.03.2017 brenda 20 ditëve nga dërgimi i rekomandimeve. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna, u konstatua se nga 27 masa të rekomanduara, janë realizuar 13 masa, ndërkohë që 7 masa janë në proces realizimi (procese gjyqësore, administrative, etj.) pa realizuar 4 masa dhe të realizuara pjesërisht 3 masa.

Masa organizative janë rekomanduar gjithsej 9 nga të cilat janë realizuar 6 masa, 1 masë është në proces realizimi dhe 2 masa janë realizuar pjesërisht.

Masa për shpërbllim dëmi janë rekomanduar gjithsej janë 10 masa të rekomanduara në vlerën 10,631,933 lekë, nga të cilat deri në datën 31.12. 2017 është realizuar vlera 2,643,495 lekë, nga të cilat 4 masa janë realizuar, 2 masa janë në proces realizimi, 1 masë është realizuar pjesërisht dhe 3 masa nuk janë realizuar.

Për vlerën prej 7,788,463 lekë e cila është e paarkëtuar, janë nxjerrë urdhëra ekzekutivë dhe është kontabilizuar shuma prej 4,844,968 lekë, ndërkohë që nuk është kontabilizuar shuma 3,143,470 lekë pasi nuk janë pranuar rekomandimet nga subjekti.

Masa për mospërdorim fondi me efikasitet, ekonomikitet dhe efikasitet, janë rekomanduar 2 masa të cilat janë realizuar.

Masa administrative janë rekomanduar gjithsej 4 masa, të cilat janë në proces realizimi.

Masa disiplinore janë rekomanduar 2 masa të cilat përfshijnë zgjidhjen e kontratës së punës për 6 punonjës dhe për 21 të tjerë janë rekomanduar vërejtje. Nga këto masa 1 konsiderohet e zbatuar për shkak të Vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ nr. 5400, datë 19.12.2017, dhe 1 nuk është zbatuar, pasi nga Kryetari i Bashkisë nuk janë pranuar rekomandimet.

Për disa nga rekomandimet e mësipërme, Bashkia Lushnjë, nuk ka nxjerrë vendimet ekzekutive dhe në disa raste është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e vendimeve për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit të përcaktuara në nenin 115, të Kodit Civil në R.SH, me ndryshime apo pagesave të përfituara tepër, të përcaktuar në nenin 203 të Kodit të Punës të R.SH, me ndryshime (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 182 -200 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lushnje të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, si masa shpërblim dëmi dhe masa disiplinore, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 242/4, datë 09.05.2016, rikërkuar me shkresën nr. 1113, datë 04.11.2016, trajtuar më hollësisht në Akt Konstatimin nr. 4, datë 02.05.2018 “Për zbatimin e rekomandimeve”.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të 15 procedurave të prokurimit publik të zhvilluara në Bashkinë Lushnje, në 6 raste procedurash u konstatuan disa mangësi në lidhje me përcaktimin e kritereve të veçanta për kualifikim, të cilat pavarësisht se nuk kanë pasur ndikim në vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, janë në mospërputhje me kërkesat e LPP e akteve nënligjore të prokurimit publik (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, në faqet 95 – 158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi:

Autoriteti kontraktor Bashkia Lushnje, të marrë masa në zbatimin e akteve ligjore e nënligjore të LPP, për përcaktimin e kritereve të veçanta për kualifikim në përputhje me objektin e prokurimit.

Në vijimësi.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 28,371,135 lekë**, si më poshtë:*

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, u konstatua se 29 subjekte nuk figurojnë të regjistruar në të dhënat e bashkisë për licencat e tregtimit të hidrokarbureve. Sa më sipër, për subjektet që nuk kanë

depozituar të dhënat në Drejtorinë e të Ardhurave në Bashkinë Lushnjë, konsiderohen si subjekte debitorë në lidhje me pagesën për licencimin (autorizimin) e tregtimit të hidrokarbureve, në vlerën **26,300,000 lekë** e cila përbën dem ekonomik për buxhetin e Bashkisë Lushnjë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 170, date 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, paragrafi III (*Më hollësisht trajtuar në pikën B, në faqet 74 -95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Lushnjë, të saktësojë shumën e detyrimit prej **26,300,000 lekë**, në ngarkim të subjekteve debitorë, sipas listës së lënë nga KLSH-ja dhe të kërkojë prej tyre arkëtimin e kësaj vlere, duke aplikuar masat shtrënguese ligjore si urdhër bllokimi në bankë apo vendosje të barrës siguroese, deri në fillimin e procedurave gjyqësore, penale apo civile, sipas rastit, sipas aneksit “tabela B18”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Sistemim dhe asfaltim, rruga Sejmenes*”, Bashkia Lushnjë, me vlerë të kontratës 43,097,897 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “L.” SH.P.K & “A.”, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt por të paguara në vlerën **872,210 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6539 prot datë 28.07.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Lushnjë dhe “L” SH.P.K & “A” (*Më hollësisht trajtuar në pikën C/4, në faqet 158 -160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Lushnjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **872,210 lekë pa TVSH** nga BOE “L.” SH.P.K & “A.” shpk SH.P.K, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 6539 prot datë 28.07.2017 me objekt *Sistemim dhe asfaltim, rruga Sejmenes*, Bashkia Lushnjë, vlerë kjo e cila përbën dem ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Sistemim dhe asfaltim, rruga e fshatit Halilaj*”, Bashkia Lushnjë, me vlerë të kontratës 34,588,662 lekë me TVSH, fituar nga OE “A. K.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **934,250 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5463 prot datë 12.06.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Lushnjë dhe “Aurora Konstruksion” SH.P.K (*Më hollësisht trajtuar në pikën C/4 në faqet 163 - 166 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Lushnjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **934,250 lekë pa TVSH** nga OE “A. K.” SH.P.K, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 5463 prot datë 12.06.2017 me objekt “*Sistemim dhe asfaltim, rruga e fshatit Halilaj*”, Bashkia Lushnjë, vlerë kjo e cila përbën dem ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “*Rikonstruksion i rrugës fshati Gorre*”, Bashkia Lushnjë të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Lushnjë dhe shoqërisë “LL.” SH.P.K., u konstatua se rezultojnë diferenca në volume për punime të pakryera inxhinierike duke shkaktuar një dem ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **264,675 lekë pa TVSH** (*Më hollësisht trajtuar në pikën C/4, në faqet 170 -174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Për këtë rekomandojmë: Të merren masa nga Bashkia Lushnjë, që t’i kërkojë operatorit ekonomik “LL.” SH.P.K. duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të

gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **264,675 lekë pa TVSH** të përfituara më tepër për diferenca në volume për punime të pakryera inxhinierike duke shkaktuar një dëm ekonomik në zbatimin e kontratës “Rikonstruksion i rrugës fshati Gorre”, Bashkia Lushnjë.”

Menjëherë

C- MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.926 datë 29.12.2016 janë likuiduar në vlerën 12,857,863 lekë për llogari të operatorit ekonomik “GPG” Lushnjë me objekt “Rikonstruksion i rrugës pedonale Abaz Bej”. Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës rezulton se sipërmarrësi në situacionin përfundimtar të punimeve dhe faturën tatimore nr.31 datë 30.11.2016 mbi zërat e punimeve ka situacionuar edhe pajisje (materiale elektrike) mbi të cilat është aplikuar TVSH.

Aplikimi në situacionin e TVSH mbi pajisjet në vlerën **218,600 lekë** mbi vlerën e punimeve ka krijuar efekt negativ financiar nga subjekti pasi është në mospërputhje me UKM nr.2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” Kreu I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit” germa A “Punime ndërtimi” pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën C/4, në faqet 64 -66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrugës në fshatin Gramsh, Njësia Administrative Dushk”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Lushnjë dhe shoqërisë “G. C.” SHPK, u konstatua se rezultojnë mospërputhje në volume për zëra punimesh të kryera të ndërtimit duke shkaktuar një efekt negativ financiar në vlerën **2,994,324 lekë** me TVSH (Më hollësisht trajtuar në pikën C/4, në faqen 167- 170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Lushnjë, të merren masa që në të ardhmen t’i kërkojë operatorëve ekonomik, të rakordojë më saktësi volumet e punimeve sipas zërave të projekt-preventivit të trajtuara në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar me volumet e punimeve të realizuara në fakt, duke parandaluar risqet që paraqiten nga veprimet evazive të shoqërive, duke krijuar efekte negative financiare.

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “c”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë që t’i kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për 3 punonjësit e mëposhtëm:**

- 1- L.B.**, me detyrë Drejtoreshë e Financës dhe Buxhetit, si nëpunës zbatues;
- 2- E.K.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore;

Pasi nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit dhe në ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, me ndryshimet e tij, rezultuan mos kontabilizime dhe mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Lushnje, sa vijon:

- Vlera totale e debisë për taksën e tokës është **245,105,403 lekë** (nga këto janë kontabilizuar 156,529,899 lekë), pjesa tjetër është e pa kontabilizuar.
- Vlera totale e debisë për taksat e tarifat të familjarëve është **81,331,585 lekë** (pa kontabilizuar).
- Vlera totale e debisë për bizneset (detyrim + kamatë) është **134,433,765 lekë**, (21,644,038 + 18,634,735 + 94,154,992 pa kontabilizuar).
- Vlera totale e debisë (detyrim + kamatë) për kontratat e qirave është **1,446,964 lekë** (pa kontabilizuar).
- Detyrimi prej **26,300,000 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lushnjë, pa kontabilizuar.
- Për 864 objekte me sipërfaqen totale 119,730 m² duhej të arkëtoheshin **18,781,075 lekë**, pa kontabilizuar (119,730 m² x 31,375 lekë x 0.5%), shumë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Lushnjë për vitin 2015, 2016, 2017.
- Shuma totale e të ardhurave të munguara në buxhetin e Bashkisë Lushnjë është 507,398,792 lekë.
- Me urdhrin nr. 130/1, datë 12.07.2016 të kryetarit të Bashkisë Lushnjë është hartuar programi i punës për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja, i strukturuar dhe përcaktuar sipas drejtorive dhe afateve përkatëse.
- Me shkresën nr. 9146/1, datë 22.07.2016, (brenda afatit prej 20 ditësh nga dërgimi i rekomandimeve) është njoftuar KLSH-ja me relacion për zbatimin e masave të lëna nga auditimi i ushtruar në këtë bashki.
- Bashkia Lushnjë mbi sa sipër me shkresën nr. 2225, datë 03.03.2017 ka hartuar dhe miratuar programin (planin e veprimit) konkret për zbatimin e rekomandimeve dhe detyrave të lëna nga auditimi i KLSH-së.
- Bashkia Lushnjë është audituar nga KLSH-ja për periudhën e veprimtarisë nga data 01.07.2014 deri më 31.12.2015, për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare. Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Lushnjë, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 9146/1, datë 22.07.2016, brenda afatit ligjor prej 20 ditësh. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, nga Bashkia Lushnjë është hartuar programi për zbatimin e rekomandimeve (plan veprimi) me urdhrin e brendshëm nr. 130/1, datë 12.07.2016, në të cilin janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afat menjëherë si dhe kanë dalë urdhrat përkatës për secilën drejtori.

3- E. S., me detyrë Drejtores e Kabinetit, në cilësinë e Koordinatorit i veprimeve të Plan-Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së, për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja periudhën e veprimtarisë nga data 01.07.2014 deri më 31.12.2015, për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare. pasi konstatohet se disa rekomandime, nuk janë vlerësuar maksimalisht, kryesisht ato që kanë lidhje me shpërblim dëmi nga nëpunësit e subjektit të audituar, duke shkelur në këtë mënyrë germën (j) të nenit 15 dhe pikën 2 të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, duke mos zbatuar dispozitat ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale, si nëpunës shtetëror i ngarkuar drejtpërsëdrejti me zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Për disa nga rekomandimet e lëna nga KLSH, Bashkia Lushnjë, nuk ka nxjerrë vendimet ekzekutive dhe në disa raste është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e vendimeve për kryerjen e

ndalesave, pa u shoqëruar me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit të përcaktuara në nenin 115, të Kodit Civil në Republikës së Shqipërisë me ndryshime apo pagesave të përfituara tepër, të përcaktuar në nenin 203 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, me ndryshime.

D- MASA ADMINISTRATIVE:

D.1- PËR INSPEKTORIATIN E MROJTJES TERRITORIT TË BASHKISË LUSHNJË

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Lushnjë t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë për 2 mbikëqyrës dhe dy kolaudatorë punimesh**, si më poshtë:

- 1- **Z. A. K.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: “Sistemim dhe asfaltim, rruga Sejmenes”, Bashkia Lushnjë” Bashkia Lushnjë, me sipërmarrës punimesh BOE “Ll.” SH.P.K & “A.” shpk, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,046,652 lekë me TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt sipas kontratës nr. 6538 prot., datë 28.07.2017.
- 2- **Z. V. T.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: “Sistemim dhe asfaltim, rruga e fshatit Halilaj”, Bashkia Lushnjë, me sipërmarrës punimesh OE “A. K.” SH.P.K, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,121,100 lekë me TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt sipas kontratës nr. 5463 prot datë 12.06.2017.
- 3- **Z. T. S.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: “Sistemim dhe asfaltim, rruga Sejmenes”, Bashkia Lushnjë” Bashkia Lushnjë, me sipërmarrës punimesh BOE “Ll.” SH.P.K & “A.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,046,652 lekë me TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, sipas kontratës nr. 6538 prot., datë 28.07.2017.
- 4- **Z. E. M.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: “Sistemim dhe asfaltim, rruga e fshatit Halilaj”, Bashkia Lushnjë, me sipërmarrës punimesh OE “A. K.” SH.P.K, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,121,100 lekë me TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt sipas kontratës nr. 5463 prot., datë 12.06.2017.

D.2- PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën

27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), **6 punonjësve** si më poshtë:

1. **M. L.**, në cilësinë e anëtares së Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, me detyrë specialiste në Drejtorinë e Planifikimit, Bashkia Lushnje;
2. **L. S.**, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, me detyrë specialist në Drejtorinë Juridike dhe te Prokurimeve;
3. **L. H.**, në cilësinë e anëtares së Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit ekonomiste me detyrë specialiste në Drejtorinë Juridike dhe te Prokurimeve.
4. **K. H.**, në cilësinë e anëtares së Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit me detyrë specialiste në Drejtorinë Juridike dhe te Prokurimeve
5. **J. B.i**, në cilësinë e anëtares së Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit me detyrë specialiste ne Drejtorinë e Finance – Buxhetit;
6. **B. K.**, në cilësinë e anëtares së Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, me detyrë specialiste ne Drejtorinë Juridike dhe te Prokurimeve

Pasi në procedurat e prokurimit të poshtë shënuara kërkesat për kualifikim janë jo në përputhje me LPP, sa vijon:

1- Procedura e prokurimit me objekt: “**Ndërhyrje Polifunkionale ne Lagjen Xhevdet Nepravishita Loti I**”, me fond limit 116, 267,730 lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 4 OE, s’kualifikuar 2 OE, dhe kualifikuar 2 OE, diferenca nga fondi limit **3 384 272 lekë, fituar nga BOE “B. “ shpk & “U. N. “ shpk**, për të cilin nga auditimi rezultoi se nuk ka gjetur zbatim neni 26, “Kontratat për punë publike”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pika 5. Konkretisht sa vijon:

a- Në kërkesat e veçanta për kualifikim janë kërkuar edhe: “2) Licenca profesionale e shoqërisë e vlefshme me kategoritë **N.S. 19 A dhe N.S. 20 A**, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, pasi nuk ka zëra në preventiv për këtë lloj kategorish sipas VKM nr.42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, **ku përcaktimet për këto kategori janë:**

1- **N.S. 19 A** (Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë)

2- **N.S. 20 A** (Shpime Gjeologe inxhinierie, puse e shpime me ujë) .

b- Gjithashtu është kërkuar që: “4).Ofertuesi duhet te ketë ne listë pagesa si dhe me kontrate pune te rregullt edhe 3 “specialiste ndërtimi”

-Në lidhje me kërkesën për specialistë ndërtimi, theksojmë se emërtim nuk është i përcaktuar në VKM nr. 627, datë 11.06.2009, “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”

c- **Gjithashtu është kërkuar** në kërkesat për makineri linjë thyerje inertesh në pronësi ose me qira, duke përjashtuar mundësinë e furnizimit. Kërkesa për makineri të tillë në pronësi apo me qira duke përjashtuar kontratat e furnizimit, kufizon numrin e konkurruesve pasi materialet e ndërtimit janë mallra që gjenden në tregun e ndërtimit.

d- Në DT është kërkuar që “**8.) Shoqëria duhet te paraqesë Certifikatë e cilësisë se punimeve për ndërtime civile, punime ne rruge etj :**

- *Certifikate: Sistemi i menaxhimit te sigurisë se Informacionit (ISO 27001 - 2013 e vlefshme)*

- *Certifikate: Sistemi i menaxhimit te energjisë (ISO 50001 : 2011 e vlefshme)*”.

-Vendosja e këtyre kriterëve është jo në përpjesëtim të drejtë me volumin e kontratës, objektin e prokurimit dhe të zërave të punimeve të parashikuara në preventiv.

2- Procedura e prokurimit me objekt: “**Rotondo e Plugut –Postbllok, Rruga e hyrjes Lushnje -Tirane (faza e dyte)**”, me fond limit 88,520,651 lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 4 OE, s’kualifikuar 5 OE, dhe kualifikuar 4 OE, diferenca nga fondi limit **2,696,449 lekë**, fituar nga OE “G..C.” shpk, për të cilin nga auditimi rezultoi se nuk ka gjetur zbatim neni 26, “Kontratat për punë publike”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pika 5.

Konkretisht sa vijon:

a- “8). Disponimi i mjeteve të mëposhtme:

<i>Nyje për prodhim inerte</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Fabrike betoni</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Fabrike asfalti</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Pajisje për sigurimin ne pune</i>	<i>Disa</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>

a/1- Në lidhje me nyjën dhe fabrikën e betonit janë kërkuar që të jenë në pronësi ose me qira. Kërkesa për makineri të tilla në pronësi apo me qira duke përjashtuar kontratat e furnizimit, kufizon numrin e konkurruesve në procedurë pasi materialet e ndërtimit janë mallra që gjenden në tregun e ndërtimit.

a/2- Në lidhje me kërkesën për “*pajise për sigurimin në punë*”, rezulton se kjo kërkesë është e tejkaluar pasi Komisioni i hartimit të kërkesave teknike për kualifikim dhe fondit limit dhe NJHDT në hartimin e preventivave, të cilat janë bërë pjesë e DT, duhej të zbatonin VKM nr. 664, datë 26.09.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.07, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10 , pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 05.05.10, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, aneksi VI, “Mbi sigurinë në kantier”, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit. Pjesë përbërëse e këtij 3% janë materialet e kërkuara krahas makinerive e mjeteve.

b- Në DT është kërkuar që: “*Shoqëria duhet te ketë ne stafin e saj 17 punonjës teknik te certifikuar nga IQT) Instituti Qendror Teknik) nga te cilët: teknik ndërtimi 2, elektrikist 3, saldator 3 , hidraulik 3, mekanik 3, elektromekanik 3*”.

Kjo kërkesë që duhet të jenë të pajisur vetëm nga IQT dhe jo edhe ekuivalent me të, është e paargumentuar dhe në kundërshtim: me nenin 9 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, nenin 7 të ligjit nr.13/2013 “ Për disa ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R